



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Infinitt" Sh.P.K. të datës 08.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "169 Paisje, rekuizita sportive" me nr. të prokurimit 616-25-5614-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Infinitt" Sh.P.K. të datës 08.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "169 Paisje, rekuizita sportive" me nr. të prokurimit 616-25-5614-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Infinitt" (tutje "parashtruesi") me datë 08.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "169 Paisje, rekuizita sportive" me nr. të prokurimit 616-25-5614-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1. – “Grupi i OE ka dorezuar ANEKS 6 Listen e kontratave te realizuara por nuk ka ofruar deshmi te mjaftueshme dokumentare Referencat apo certifikatat per kryerjen e furnizimeve ne vlere jo me pak se 50,000.00”.

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se komisioni vlerësues ka kërkuar sqarime shtesë nga OE dhe përmes sqarimeve shtesë OE ka dorëzuar referencat në fjalë sipas listës së kontratave të cilën e ka bashkëngjitur në ofertë. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

P.2. – “Grupi i OE poashtu kane dorezuar oferte jo-normalisht te ulet e cila eshte dashur te trajtohet nga AK konform nenit 61.1 te LPP-se dhe nenit 41.3 te RRPP”.

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se diferenca në mes të cmimit të ofruar nga parashtruesi dhe tenderuesi i rekomanduar është vetëm rreth 3-4 mijë euro. Ndërsa cmimi i ofruar nga tenderuesi i rekomanduar është shumë më pak sesa 30% e mesatares së ofertave të përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj edhe ky pretendim është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.09.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.